



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E ARSIMIT, SPORTIT DHE RINISË

INSTITUTI I ZHVILLIMIT TË ARSIMIT

**PROGRAMI I ZHVILLIMIT PROFESIONAL  
PËR MARRJEN E SHKALLËVE TË KUALIFIKIMIT TË MËSUESVE  
TË ARSIMIT PARASHKOLLOR**

**2018**

**1. HYRJE**

Profesioni i mësuesit kërkon përkushtim, përgjegjshmëri dhe standarde të larta pune dhe etike. Mësuesi vepron me ndershmëri dhe integritet të lartë profesional, zotëron përbajtjen e programeve lëndore që jep mësim, përditëson dijet dhe aftësitë e tij nëpërmjet trajnimeve dhe kualifikimeve që zhvillon, krijon dhe pasuron vazhdimisht portofolin e tij profesional, përfshihet në procesin e vetëvlerësimit, dokumenton vlerësimet që i bëhen, krijon marrëdhënie korrekte me prindërit në interesin më të mirë të fëmijëve.

Programi i zhvillimit profesional për efekt marrjen e kategorive të kualifikimit të mësuesve të arsimit parashkollor është hartuar nga grupi i punës, i ngritur nga Instituti i Zhvillimit të Arsimit (IZHA) për t'u ardhur në ndihmë të gjithë mësuesve në përgatitjen për testimin kombëtar për marrjen e kategorive të kualifikimit, si dhe të gjitha Drejtorive Arsimore Rajonale dhe Zyrave Arsimore për të organizuar zhvillimin profesional për të gjithë mësuesit që do të hyjnë në këtë proces.

Programi është zhvilluar duke iu përgjigjur kërkesave që MASR ka vendosur për mësuesit që kualifikohen. Programi është hartuar duke mbajtur parasysh fushat kryesore në të cilat testohen njohuritë dhe aftësitë e mësuesve, të tilla si:

- Dokumentet zyrtare<sup>1</sup> të cilat kanë të bëjnë me veprimtarinë mësimore - edukative të mësuesve;

<sup>1</sup> Bëhet fjalë për të gjitha dokumentet ligjore, urdhëresat dhe udhëzimet e MASR-së që zbatohen në institucionet parashkollore.

- Standardet dhe programet e parashkollorit;
- Aspekte të pedagogjisë dhe të metodologjisë së mësimdhënies dhe të të nxënit në arsimin parashkollor;
- Aspekte të etikës dhe të komunikimit;
- Aspekte të drejtshkrimit të gjuhës shqipe;
- Përmbajtja shkencore e kurrikulës së arsimit parashkollor.

## **2. QËLLIMI I PROGRAMIT**

Programi i zhvillimit profesional të mësuesve për efekt kualifikimi synon:

- *të ofrojë* një program orientues për t'u ardhur në ndihmë të gjithë mësuesve të arsimit parashkollor në arsimin parauniversitar për të realizuar veprimtaritë kualifikuese dhe trajnuese, si dhe DAR/ZA-ve, për të organizuar zhvillimin profesional të mësuesve. Në këtë aspekt programi mund të plotësohet nga DAR/ZA-të përkatëse, sipas kushteve dhe mundësive konkrete;
- *të ofrojë* një program të detyruar, për të cilin mësuesit do të përgatiten, për të përballuar me sukses kërkesat që ka testimi kombëtar.

**Programi synon që mësuesi:**

- *të njohë* dhe *të zbatojë* legjislacionin arsimor e në mënyrë të veçantë, të risive më të fundit të reformës arsimore;
- *të zotërojë* kompetencat profesionale të kuadrit mësimdhënës, për të ndikuar drejtpërdrejtë në rritjen e efektivitetit të veprimtarisë mësimore-edukative;
- *të zbatojë* rregullat e etikës dhe të komunikimit në institucionet parashkollore;
- *të zotërojë* konceptet bazë, ligjësitë shkencore dhe t'i zbatojë me saktësi gjatë mësimdhënies, në përputhje me zhvillimin moshor të fëmijëve 3-6 vjeç;
- *të zbatojë* rregullat e etikës dhe të komunikimit në punën e tij në shkollë.

## **3. PËRMBAJTJA E PROGRAMIT**

Programi është strukturuar sipas fushave kryesore të zhvillimit profesional, të përmendura më sipër. Për të qenë lehtësisht i përdorshëm, programi është paraqitur sipas një formati të caktuar. Për secilën fushë, përcaktohen:

- kompetencat profesionale, si dhe rezultatet e pritshme për realizimin e këtyre kompetencave;
  - literatura përkatëse rekomanduese në funksion të përvetësimit të kompetencave të fushës.
- Përshkallëzimi i njohurive dhe i aftësive profesionale, të cilat lidhen me kompetencat e secilës fushë të testimit, do ta ndihmojnë mësuesin që të identifikojë çështjet në të cilat duhet të përqendrohet.

<b>Fusha: Dokumentacioni zyrtar</b>	
<b>Kompetenca</b>	<b>Literatura e rekomanduar</b>
<p><b>Zbatimi me përgjegjshmëri i kërkesave të legjislacionit dhe të dokumentacionit shkollor</b></p> <p><i>Mësuesi i parashkollorit:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• zotëron Ligjin për arsimin parauniversitar dhe Dispozitat normative të këtij sistemi;</li> <li>• zbaton legjislacionin, udhëzimet dhe rregulloret për planifikimin dhe zbatimin e kurrikulës;</li> <li>• zbaton legjislacionin, udhëzimet dhe rregulloret për personelin e kopshtit;</li> <li>• zotëron përmbajtjen e dokumentacionit parashkollor;</li> <li>• zbaton udhëzimet e MAS në funksion të përmirësimit të procesit veprimtarisë mësimore-edukative;</li> <li>• zbaton etikën profesionale të mësuesit;</li> <li>• respekton të drejtat dhe liritë e fëmijëve;</li> <li>• respekton detyrat, të drejtat, përgjegjësitë dhe liritë e mësuesit;</li> <li>• zbaton kërkesat e rregulloreve dhe të udhëzimeve për zhvillimin profesional</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Ligji nr. 69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.</li> <li>• Urdhri për miratimin e Dispozitave Normative për arsimin parauniversitar (DN), nr 343, datë 19.08.2013 (për arsimin parashkollor).</li> <li>• Udhëzimi nr. 16, datë 31.07.2017 “Për vitin shkollor 2016-2017 në sistemin arsimor parauniversitar”.</li> <li>• Udhëzimi nr. 44, datë 16.10.2014 “ Për disa shtesa dhe ndryshime në udhëzimin nr. 21 datë 23.07.2010 “Për normat e punës mësimore – edukative dhe numrin e nxënësve për klasë në institucionet e arsimit parauniversitar”.</li> <li>• Udhëzimi nr. 5 datë 25.02.2013 “Për standardet e mësuesit”.</li> <li>• Udhëzimi nr. 1, datë 20.01.2017 “Për funksionimin e sistemit të zhvillimit të vazhdueshëm profesional të punonjësve</li> </ul>

të mësuesit.	arsimorë”.
--------------	------------

<b>Fusha: Programet lëndore</b>	
<b>Kompetenca</b>	<b>Literatura e rekomanduar</b>
<p><b>Zbatimi me përgjegjshmëri i kërkesave të dokumentacionit kurrikular të arsimit parashkollor</b></p>	
<p><i>Mësuesi i parashkollorit:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• qëndron i mirinformuar për të rejtat e reformës kurrikulare, pjesë e të cilës është edhe arsimit parashkollor;</li> <li>• analizon dhe bën interpretime për standardet e zhvillimit dhe të nxënimit të fëmijëve 3-6 vjeç;</li> <li>• zbaton parimet, synimet, objektivat e përgjithshme dhe specifike, fushat e studimit, integrimin ndërlëndor, metodikën e zbatimit të programeve të parashkollorit;</li> <li>• njeh karakteristikat e zhvillimit të përgjithshëm të fëmijëve të moshës 3-6-vjeçare dhe bën planifikime kurrikulare mbi bazën e tyre.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Korniza kurrikulare e arsimit parashkollor, 2014.</li> <li>• Standardet e zhvillimit dhe të nxënimit të fëmijëve 3-6 vjeç.</li> <li>• Kurrikula bërthamë klasa KP-5, 2014.</li> <li>• Programet e arsimit parashkollor për 3-4- vjeçarët, IZHA, 2017.</li> <li>• Programi i arsimit parashkollor për 4-5- vjeçarët, IKS, 2007.</li> <li>• Programi i arsimit parashkollor për 5-6- vjeçarët, IKS, 2007.</li> <li>• “Udhëzuesi për inspektimin e plotë të kopshtit”, IKAP, 2011.</li> <li>• Literaturë që ka në fokus aspekte të ndryshme të përmbajtjes, analizës, zbatimit të kurrikulës së parashkollorit.</li> </ul>

<b>Fusha: Aspekte të pedagogjisë dhe të metodologjisë së punës në arsimin parashkollor</b>	
<b>Kompetenca I</b>	<b>Literatura e rekomanduar</b>
<p>Zotërimi i koncepteve bashkëkohore të mirërritjes dhe të edukimit të fëmijëve parashkollorë.</p>	
<p><i>Mësuesi i parashkollorit:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• është njohës i mirë i aspekteve psikologjike dhe pedagogjike që i</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Standardet e zhvillimit dhe të nxënimit të fëmijëve 3-6 vjeç.</li> <li>• Udhëzuesi për inspektimin e plotë të</li> </ul>

<p>përkasin fëmijërisë së hershme;</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• është njohës i mirë i standardeve të fushës së zhvillimit të përgjithshëm fizik të fëmijës 3-6 vjeç;</li> <li>• është njohës i mirë i standardeve të fushës së zhvillimit gjuhësor të fëmijës 3-6 vjeç;</li> <li>• është njohës i mirë i standardeve të fushës së zhvillimit intelektual të fëmijës 3-6 vjeç;</li> <li>• është njohës i mirë i standardeve të fushës së zhvillimit social-emocional të fëmijës 3-6 vjeç;</li> <li>• menaxhon situata, sjellje dhe veprime të ndryshme fëmijësh;</li> <li>• përzgjedh dhe përshtat lojëra për secilën fushë zhvillimi;</li> <li>• dallon nëse një fëmijë paraqet vështirësi në të nxënë, është me aftësi të kufizuara ose ka nevoja të veçanta;</li> <li>• harton plan edukativ individual (PEI) për fëmijët me aftësi të kufizuar.</li> </ul>	<p>kopshtit”, IKAP, 2011.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Literaturë që ka në fokus koncepte bashkëkohore të edukimit të fëmijëve parashkollorë dhe të mësimdhënies në këtë moshë.</li> </ul>
<p><b>Kompetenca II</b></p> <p><b>Përdorimi i metodave aktive të të mësuarit dhe i lojës për zhvillimin tërësor të fëmijëve parashkollorë.</b></p>	<p><b>Literatura e rekomanduar</b></p>
<p><i>Mësuesi i parashkollorit:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• është njohës i mirë i aspekteve pedagogjike dhe didaktike të mësimdhënies dhe të nxënimit në moshën parashkollorë;</li> <li>• është njohës i mirë i stileve të të nxënimit;</li> <li>• krijon në kopsht një mjedis nxitës dhe</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Standardet e zhvillimit dhe të të nxënimit të fëmijëve 3-6 vjeç.</li> <li>• Udhëzuesi për inspektimin e plotë të kopshtit, IKAP, 2011.</li> <li>• Literaturë që ka në fokus koncepte bashkëkohore të edukimit të fëmijëve parashkollorë dhe të mësimdhënies në</li> </ul>

<p>motivues sipas treguesve cilësorë;</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• organizon projekte dhe miniprojekte me tematika të caktuara;</li> <li>• planifikon veprimtari që nxisin aftësitë krijuese të fëmijëve;</li> <li>• vlerëson rolin e lojës si veprimtaria kryesore nëpërmjet të cilës fëmijët parashkollorë zhvillohen dhe mësojnë;</li> <li>• përdor metodat aktive të të mësuarit, duke pasur fëmijën në qendër;</li> </ul>	<p>këtë moshë.</p>
<p style="text-align: center;"><b>Kompetenca III</b></p> <p><b>Planifikimi cilësor i veprimtarisë mësimore-edukative duke respektuar nevojat biologjike dhe moshore të fëmijëve parashkollorë dhe regjimin ditor të kopshtit.</b></p>	<p><b>Literatura e rekomanduar</b></p>
<p><i>Mësuesi i parashkollorit:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• planifikon veprimtari mësimore-edukative sipas veçorive psiko-pedagogjike të kësaj moshe (3-6 vjeç);</li> <li>• zbaton praktika pedagogjike në përshtatje me planifikimin mujor, javor dhe ditor;</li> <li>• zhvillon forma dhe lloje të ndryshme veprimtarie të alternuara, si: në grup të madh; në grup të vogël dhe individuale;</li> <li>• zhvillon forma dhe lloje të ndryshme veprimtarie të alternuara, si: të lira; të sugjeruara dhe të drejtuara;</li> <li>• zhvillon forma dhe lloje të ndryshme veprimtarie të alternuara, në ato që kërkojnë përqendrim e vëmendje apo çlodhëse;</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Udhëzuesi për inspektimin e plotë të kopshtit, IKAP, 2011.</li> <li>• Literaturë që ka në fokus koncepte bashkëkohore të edukimit të fëmijëve parashkollorë dhe të mësimdhënies në këtë moshë.</li> </ul>

<ul style="list-style-type: none"> <li>• zhvillon forma dhe lloje të ndryshme veprimtarie të alternuara, që zhvillohen në mjedise të ndryshme (ulur, në këmbë, në pozicion çlodhës, në të njëjtin vend apo në vende të ndryshme); në një mjedis tjetër të kopshtit, brenda apo jashtë kopshtit;</li> <li>• zhvillon forma dhe lloje të ndryshme veprimtarie të alternuara, si: të udhëhequra nga mësuesja e grupit apo të udhëhequra nga një person tjetër (prindi);</li> <li>• zbaton kohëzgjatjen e veprimtarive duke sugjeruar përdorimin e këndeve dhe lodrave, në funksion të moshës së fëmijëve;</li> <li>• zbaton veprimtari individuale të vëzhgueshme, duke dalluar shenjat e dukshme të lodhjes, të mungesës së interesit etj.</li> </ul>	
<b>Kompetenca IV</b> <b>Përdorimi i instrumenteve të ndryshme të vlerësimit</b>	<b>Literatura e rekomanduar</b>
<p><i>Mësuesi i parashkollorit:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• vlerëson rolin e lojës si veprimtaria kryesore nëpërmjet të cilës fëmijët parashkollorë zhvillohen, mësojnë, por edhe vlerësohen;</li> <li>• përdor instrumente të ndryshme vëzhgimi dhe vlerësimi;</li> <li>• Mban shënime për ecurinë, përfshirjen dhe përparimin e fëmijëve.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Literaturë që ka në fokus koncepte bashkëkohore të vlerësimit të fëmijëve parashkollorë.</li> </ul>

<b>Fusha: Aspekte të etikës dhe të komunikimit</b>	
<b>Kompetenca</b>	<b>Literatura</b>
<p><b>Zbatimi i rregullave të etikës dhe komunikimit si elemente të domosdoshme në të gjithë punën e mësuesit</b></p>	
<p><i>Mësuesi i parashkollorit:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• njeh rregullat e etikës dhe sjelljes që duhen respektuar në marrëdhënie me drejtuesen e institucionit arsimor, me koleget, me stafin ndihmës dhe mbështetës, fëmijët, prindërit dhe komunitetin;</li> <li>• sillet në përputhje me rregullat e etikës dhe të sjelljes në marrëdhënie me drejtuesen e institucionit arsimor, me koleget, me stafin ndihmës dhe mbështetës, fëmijët, prindërit dhe komunitetin gjatë punës së tij brenda dhe jashtë institucionit arsimor.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Kodi i Etikës së mësuesve në arsimin parauniversitar.</li> <li>• Literaturë dhe materiale burimore që trajtojnë çështje të etikës dhe të komunikimit.</li> </ul>

<b>Fusha: Aspekte të drejtshkrimit të gjuhës shqipe</b>	
<b>Kompetenca</b>	<b>Literatura</b>
<p><b>Zbatimi i rregullave të drejtshkrimit të gjuhës shqipe</b></p>	
<p><i>Mësuesi i parashkollorit:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• zbaton rregullat e drejtshkrimit të standardit të gjuhës shqipe, në të folur, në të lexuar dhe në të shkruar;</li> <li>• zbaton rregullat e drejtshkrimit të gjuhës shqipe në çdo veprimtarive në institucionin arsimor.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Drejtshkrimi i gjuhës shqipe.</li> </ul>



**Fusha: Përmbajtja shkencore e lëndëve**

<p align="center"><b>Kompetenca</b></p> <p><b>Zotërimi i koncepteve dhe i dukurive shkencore dhe transmetimi në mënyrë shkencore dhe didaktike në përshtatje me zhvillimin moshor të fëmijëve parashkollorë.</b></p>	<p align="center"><b>Literatura</b></p>
<p><i>Mësuesi i parashkollorit:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• zotëron koncepte shkencore, dukuritë, ligjësitë që trajtohen në arsimin parashkollor në nivel shkencor dhe didaktik;</li> <li>• transmeton te fëmijët parashkollorë ato njohuri, shprehi, aftësi dhe vlera që janë në përputhje me zhvillimin e tyre dhe me kërkesat e programeve;</li> <li>• përmbush kërkesat e secilës fushë kurrikulare dhe i transmeton saktësisht te fëmijët nga ana shkencore.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Kurrikula bërthamë klasa KP-5, 2014.</li> <li>• Standardet e zhvillimit dhe e të nxëniet të fëmijëve 3-6 vjeç.</li> <li>• Programet e arsimit parashkollor për 3-4- vjeçarët, IZHA, 2007.</li> <li>• Programi i arsimit parashkollor për 4-5- vjeçarët, IKS, 2007.</li> <li>• Programi i arsimit parashkollor për 5-6- vjeçarët, IKS, 2007.</li> <li>• Botime ndihmëse, buletine, enciklopedi dhe materiale të tjera burimore që trajtojnë përmbajtjen shkencore të fushave të ndryshme kurrikulare të arsimit parashkollor.</li> </ul>